



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_189\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_190\_04\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_190\_04\_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 04.05.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Eshref Haziri (shifra e konsumatorit DPR – 5397) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së me datë 18.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.09.2008, lidhur me kontestimin për parapagimin për RTK.

- Me datë 24.09.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar parapagimin për RTK.  
**Provë:** Dëftesa e ankesës në KEK
- Me datë 24.09.2008 Departamenti për Konsumator iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar e duke u thirrur në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2003/12.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 24.09.2008
- Me datë 18.02.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.

- Me datë 22.04.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar konsumatorin lidhur me taksën për emetuesin publik (RTK).  
**Provë:** Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 22.04.2009
- Me datë 04.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_190\_04\_09.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_190\_04\_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar